

**Akt themelimi**  
**I shoqërise me përgjegjësi të kufizuar**  
**" EUROPA AUTOGAS " shpk**

Ne bazë të ligjit 9901 datë 14.04.2008 Për tregtarët dhe shoqëritë tregtare dhe ligjit 9723 datë 03.05.2007 'Për qendrën kombëtare të biznesit ' sot më datë 10/01/2024, unë i nënshkruari:

1-Armant Bardho, shtetas shqiptar , i biri i Petraq, lindur më 23/01/1986 në Bubullimë, Lushnje dhe banues në Lagjja « 1 Maji », Fier , mbajtës i letërnjoftimit me nr. 034400650 , madhor me zotësi të plotë juridike për të vepruar (në vijim « **ortaku i vetëm** :

themeloj një shoqëri me përgjegjësi të kufizuar sipas legjislacionit Shqiptar në fuqi, dhe në kushtet e përcaktuara në këtë Statut.

Aktiviteti i kesaj shoqërie do të rregullohet nga statuti i saj, i cili është pjese perberese e ketij akti themelimi dhe i bashkangjitet si shtojca 1.

**Neni 1**

Emri i shoqërise është " **EUROPA AUTOGAS** " shpk

**Neni 2**

Selia e Shoqërisë ndodhet në adresën :

Lushnje, Njesia Administrative Kolonjë, Rruga Nacionale Fier-Lushnje, zona kadastrale 1030, pasuria 191/67, godinë 1 katëshe.

Shoqëria mund të krijojë degë, zyrë, filiale dhe të zhvilloj aktivitetet në vende të tjera, brenda ose jashtë territorit të Republikës së Shqipërisë me vendim të ortakëve të Shoqërisë.

**Neni 3**

Shoqëria do të zhvilloj aktivitetin e saj për një kohëzgjatje të pacaktuar duke filluar nga momenti i regjistrimit të saj në Regjistrin Tregëtar të Republikës së Shqipërisë.



Prishja dhe likuidimi i Shoqërisë do të përcaktohet me vendim të asamblesë së përgjithshme të ortakëve, në përputhje me dispozitat e këtij Statuti dhe legjislacionin në fuqi.

#### Neni 4

Objekti I shoqërise është si më poshtë:

Import-Eksport kite impjante gazi. Servis automjete.Ndryshime konstruktive të mjeteve. Shitblerje mjetesh , të reja dhe të përdorura.Shërbime karoatreci.Import – eksport automjetesh të ndryshme. Tregti pjesë këmbimi dhe aksesorë të ndryshëm për automjete.Tregeti automjetesh.Dhenie me qira e automjeteve.Ç'montim automjetesh.

#### Neni 5

Kapitali themeltar I shoqërisë është 1.000.000 ( njëmilion ) lekë , I cili ndahet në 1 kuotë, e cila zotërohet nga ortaku i vetëm e saj. Kapitali themeltar është i nënshkruar nga ortaku i vetëm e saj.

Ky kapital mund te shtohet sipas dispozitave ligjore dhe sipas vendimit te ortakut te vetëm e saj.

Ortaku i Shoqërisë është si vijon :

**1:** Armant Bardho,shtetas shqiptar , i biri i Petraq, lindur më 23/01/1986 në Bubullimë,Lushnje dhe banues në Lagjja « 1 Maji », Fier , mbajtës i letërnjoftimit me nr. 034400650,madhore me zotësi të plotë juridike për të vepruar (në vijim « **ortaku i vetëm** »)

Ortaku i vetëm zotëron 1 kuotë me vlerë nominale 1.000.000 ( njëmilion ) lekë, që përfaqëson 100% të kapitalit të regjistruar të shoqërisë dhe të të drejtës së votës në asamblenë e përgjithëshme të ortakëve sipas këtij statuti.

#### Neni 6

Shoqëria ushtron aktivitetin e saj nëpërmjet vendimeve të ortakëve të shoqërisë.

Administrator i Shoqërisë do të jetë: Armant Bardho,shtetas shqiptar , i biri i Petraq, lindur më 23/01/1986 në Bubullimë,Lushnje dhe banues në Lagjja « 1 Maji », Fier , mbajtës i letërnjoftimit me nr. 034400650,madhore me zotësi të plotë juridike për të vepruar- i cili do të emërohet për një mandat fillestar 5 (pesë) vjeçar me të drejtë ri-emërimi.

Administratori ka liri të plotë për drejtimin e zakonshëm të shoqërisë dhe mund të kryejë të gjitha llojet e veprimeve dhe cdo lloj marrëveshje për realizimin e qëllimeve të shoqërisë duke përjashtuar rastet që janë të parashikuara në ligj dhe në Statut që i takojnë Asamblese së Ortakeve. Raporti i administrimit, inventari dhe llogaritë vjetore hartohen nga Administratori.

### **Neni 7**

Kontrolli mbi veprimtarinë e shoqërisë si dhe gjithë aktivitetin e shoqërisë i besohet një eksperti kontabël. Ky ekspert do të qëndrojë në detyrë për aq kohë sa përcaktohet me ligj dhe mund të rizgjidhet. Asambleja cakton dhe shpërblimin përkatës, kur nuk ka norma të vecanta ligjore.

### **Neni 8**

Cështjet e tjera që nuk janë trajtuar në këtë akt themelimi, do të referohen ligjit Nr. 9901 datë 14/04/2008 " Për Tregtarët dhe Shoqëritë tregtare" i ndryshuar, si dhe legjislacionit shqiptar në fuqi, si dhe akteve të tjera ligjore dhe nënligjore të dala në zbatim të tyre.

### **Neni 9**

Akti i themelimit është hartuar në dy kopje në gjuhën shqipe, me të njëjtën vlerë.

## **ORTAKU THEMELUES**

**Armant Bardho**

